



QENDRA E TRAJNIMEVE &
BURIMEVE PER AVOKIM



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



THE ADVOCATE

Përkrah Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi V • Numri 7 • Gusht 2007

Mundësi financimi për OJQ-të

ATRC ka shpallur rundin e shtatë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim

ATRC ka shpallur më 16 gusht konkurs për OJQ-të kosovare për rundin e shtatë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile të IREX-it.

Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim do t'u ndahen OJQ-ve, projekt-propozimet e të cilave përbajnë komponentë partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, OJQ-ve dhe sektorëve të tjerë (qeveria lokale ose qendrore, biznes private). Projektet po ashtu duhet të adresojnë çështje të rëndësishme në njërin prej këtyre tri fushave: transparenca dhe anti-korrupsioni, zhvillimi i

komunitetit ose pajtimi ndëretnik, dhe zgjidhja e konfliktit. Kohëzgjatja e këtyre granteve është 5 muaj. OJQ-të mund të aplikojnë për grant deri në \$ 16,500. *Afati i fundit për dorëzim të projekteve është 3 shtatori, 2007.*

Dokumentet gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të konkursit (përfshirë përshkrimin e programit, kriteret e ndarjes së granteve, afatet kohore për aplikim, kriteret e përzgjedhjes dhe procesi i shqyrtimit, format e kërkuara për aplikim si dhe formati dhe udhëzuesi i propozimit) mund të merren në ATRC, rruga Agim Ramadani, Nr.15, Prishtinë ose të shkarkohen nga

faqja e Internetit www.advocacy-center.org.

Programi Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP) është iniciativë trevjeçare e financuar nga USAID dhe e realizuar nga IREX. Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile dhe komunitetit të OJQ-ve në Kosovë, që të jetë sektor i qëndrueshëm dhe të luaj rol domethënës në përfaqësimin e dallimeve qytetare si dhe në formulimin e politikave publike.

Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose grants@advocacy-center.org.

PËRMBAJTJA

Faqe 1

Mundësi financimi për OJQ-të
ATRC ka shpallur rundin e shtatë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim

Fletëpalosja e re e ATRC-së

Faqe 2

Mjedisi dhe komuniteti
Qeveria lokale dhe ajo qendrore pranojnë rregullimin e lumit Mirusha - rezultat ky i punës avokuese të "Agro Ecos"

Mundësi për fonde të BE-së për OJQ-të

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së:
www.advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

Fletëpalosja e re e ATRC-së

ATRC ka publikuar në muajin gusht fletëpalosjen e re me qëllim të ofrimit të informacionit të shkurtër dhe gjithëpërfshirës për ATRC-në. Fletëpalosja është përmbledhje e profilit të ATRC-së, shërbimeve të trajnimit dhe informimit, menaxhimit të granteve, aktiviteteve publike, bibliotekës, databazës së OJQ-ve dhe resurseve të tjera.

Fletëpalosja mund të shkarkohet nga www.advocacy-center.org



Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Executive Director
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org

**Financial & Administration
Manager**
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

Grant Manager
KUSHTRIM KALOSHI
kushtrimk@advocacy-center.org

Grant Officer
XHAFER AHMETI
xhafer@advocacy-center.org

Grant Officer
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

Grant Finance Manager
SAFETA XHEKOVIQ
safeta@advocacy-center.org

**Training & Consultancy
Services Manager**
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
AFERDITA SURROI
aferdita@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
KUSHTRIM ISLAMI
kushtrim@advocacy-center.org

Trainer & Consultant
NORA SUSURI
nora@advocacy-center.org

**Communication & Outreach
Manager**
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org

IT and Database Manager
ARSIM KOSUMI
arsim@advocacy-center.org

Mjedisi dhe komuniteti

Qeveria lokale dhe ajo qendrore pranojnë rregullimin e lumit Mirusha - rezultat ky i punës avokuese të "Agro Ecos"



*Shtrati i lumit Mirusha,
i cili kalon nëpër rajonin e Gjilanit*

Lumi Mirusha kalon nëpër Komunën e Gjilanit. Uji i tij është kontaminuar nga derdhjet e ujerave të zeza dhe paraqet kërcënim serioz për shëndetin e komuniteteve që jetojnë përreth lumit.

Riparimin e sistemit të ujërave të zeza dhe rregullimin e shtratit të lumit, OJQ-ja "Agro Eco" i ka identifikuar si çështje urgjente me qëllim të parandalimit të përkapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe shpërthimit të epidemive.

"Agro Eco" është OJQ e themeluar së fundi në Gjilan, e cila synon mbrojtjen e mjedisit në komunën e Gjilanit për ujë më të pastër

dhe kualitativ për këtë rajon. Prioritet i saj është rregullimi i lumit Mirusha. "Agro Eco" ka fokusuar përpjekjet e veta avokuese në edukimin

dhe ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtjen e mjedisit, mobilizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve aktiv në procesin e vendim-marrjes, dhe ndikimin në vendimet e qeverisë për të rregulluar shtratin e lumit gjatë periudhës 2007-2009.

Fillimisht "Agro Eco" ka organizuar debate të hapura me qytetarët që më së shumti pësojnë nga kjo situatë, punëtori për rëndësinë e shprehjes së shqetësimeve nga qytetarët për mbrojtje të mjedisit, dhe ka inicuar radio debate për publikun në rajonin e Gjilanit.

Të nxitur nga qytetarët për përgjigje më të shpejtë dhe

nevojën për veprime të menjëhershme, "Agro Eco" ka vazhduar avokimin drejt institucioneve qeveritare.

Si rezultat i kësaj, Asambleja Komunale e Gjilanit dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH) janë pajtuar për të rregulluar lumin Mirusha dhe kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi të datës 4 maj, 2007. Memorandumi përcakton përgjegjësitë, kontributin dhe pjesëmarrjen financiare të MAPH-së me gjithsej 225.000 €, dhe 47,000.00 € nga Kuvendi Komunal i Gjilanit.

"Komunikimi me organet ekzekutive të Komunës dhe puna avokuese për të pasur ndikim në vendimet e qeverisë, kanë qenë sfidat kryesore që kemi hasur gjatë punës. Me gjithë këtë, kemi arritur sukses", ka deklaruar Shahadije Rexhepi, drejtoreshë e "Agro Ecos".

Iniciativa e Agro - Ecos është përkrahur nga ATRC dhe IREX.

Mundësi për fonde të BE-së për OJQ-të

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) organizon trajnim për përfaqësuesit e shoqërisë civile kosovare më 3, 4 dhe 5 shtator 2007, të titulluar "Proceduarat e Aplikimit për Fonte të BE-së". Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të mësojnë për fondet e BE-së dedikuar rajonit dhe posaçërisht Kosovës gjatë 2007-2013. Trajnimi do të fokusohet në burimet kryesore të financimit për Kosovën në kuadër të IPA,



CARDS dhe granteve për OJQ.

Veç kësaj, pjesëmarrësit mund të mësojnë për proceduarat e tenderimit, menaxhim të projekt propozi-

meve të financuara nga BE-ja, raportim dhe procedurat e auditimit të projekteve të financuara nga Komisioni Evropian.

Iniciativa është pjesë e projektit "Organizatat e Shoqërisë Civile në Përkrahje të Integritimit Evropian dhe Racional të Kosovës" të implementuar nga KCSF dhe menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim.

Për më shumë informata, vizitoni www.kcsffoundation.org